



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.101

2004

28 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.4438 datë 24.12.2004	Për falje dënimi..... 6763
Vendim i KM nr.835, datë 3.12.2004	Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile..... 6765
Vendim i KM nr.836, datë 3.12.2004	Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë..... 6765
Vendim i KM nr.839, datë 17.12.2004	Për miratimin e dokumentit “Rregullorja e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”..... 6769
Vendim i KM nr.840, datë 17.12.2004	Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik... 6786
Vendim i KM nr.841, datë 17.12.2004	Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT”, të autostradës Rrogozhinë-Tiranë (Pezë)-Rinas-Thumanë 6787
Vendim i KM nr.845, datë 17.12.2004	Për shfuqizimin e vendimit nr.506, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për ndërtimin me koncesion të autostradës Rrogozhinë-Pezë-Degëzim Tiranë-Vorë-Thumanë dhe caktimin e Organit Shtetëror të Autorizuar”..... 6788

Vendim i KM nr.846, datë 17.12.2004	Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT, të Rrugës Rrëshen-Kalimash, pjesë e korridorit Durrës-Kukës-Morinë.....	6788
Vendim i KM nr.882, datë 22.12.2004	Për shpërblimin e ish-punonjësve të uzinës së ferrokromit në Burrel.....	6789
Vendim i KKRT nr.294, datë 22.12.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Asparag”.....	6789
Vendim i KKRT nr.295, datë 22.12.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Bulqiza”...	6790
Vendim i KKRT nr.296, datë 22.12.2004	Për dhënie licence për radion vendore private“Lezha”.....	6790
Vendim i KKRT nr.297, datë 22.12.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “TV Kukësi”....	6791
Vendim i KKRT nr.298, datë 22.12.2004	Për heqjen e licencës së “TV Shijak”	6791
Vendim i KKRT nr.299, datë 22.12.2004	Për heqjen e licencës së “TV Drini”	6794

DEKRET
Nr. 4438, datë 24.12.2004

PËR FALJE DËNIMI

Në mbështetje të neneve 92 pika b dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të organeve të Pushtetit Lokal, me rastin e festave të fundvitit,

DEKRETOJ:

Neni 1

1. Dritan Nikoll Lusha, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.55, datë 30.10.2001, i falet dënimi i mbetur.
2. Eduart Xhevit Allka, dënuar nga Gjykata e Rrethit Gramsh, me vendimin nr.19, datë 29.8.2002, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
3. Gëzim Kaplan Aleksi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.533, datë 15.9.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
4. Arti Qazim Spahiu, dënuar nga Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr.57, datë 2.5.2001, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
5. Man Arif Meshi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kukës, me vendimin nr.42, datë 14.5.1996, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
6. Eduard Bexhet Sinanaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.34, datë 13.2.2001, i falen 3 vjet nga dënimi i mbetur.
7. Setki Halit Dishi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.44, datë 14.9.1999, i falet dënimi i mbetur.
8. Klodian Perlat Sina, dënuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.257, datë 18.12.2002, i falet dënimi i mbetur.
9. Arnold Sokrat Durri, dënuar nga Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr.113, datë 22.12.1999, i falet dënimi i mbetur.
10. Fran Mirash Nika, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.43, datë 14.4.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
11. Marjan Pashko Kola, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.80, datë 4.4.2002, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
12. Astrit Haxhi Haruni, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.188, datë 14.4.1993, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
13. Granit Hazir Trezhnjeva, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.67, datë 3.2.2003, i falet dënimi i mbetur.
14. Idajet Daut Vrenozi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.113, datë 24.3.2000, i falen 4 vjet nga dënimi i mbetur.
15. Dritan Josif Kondakçiu, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.1082, datë 17.11.2004, i falet dënimi i mbetur.
16. Gëzim Man Lusha, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pukë, me vendimin nr.8, datë 4.2.2003, i falet dënimi i mbetur.
17. Enkelejd Semeri Backa, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.108, datë 13.8.2001, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
18. Leonard Trashëgim Dule, dënuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.290, datë 23.4.2004, i falet dënimi i mbetur.
19. Astrit Bashkim Gjata, dënuar nga Gjykata e Rrethit Librazhd, me vendimin nr.65, datë 23.11.2001, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
20. Drini Sherif Gjini, dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, me vendimin nr.13, datë 31.1.2003, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
21. Andrea Vladimir Foti, dënuar nga Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.12, datë 22.7.2004, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

22. Arven Muhamet Ymetllari, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pogradec, me vendimin nr.49, datë 27.6.2001, i falet dënimi i mbetur.
23. Nikolla Jonuz Lleshanaku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.61, datë 23.4.2001, i falet dënimi i mbetur.
24. Diter Zaçe Veshi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tepelenë, me vendimin nr.37, datë 9.7.2003, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
25. Pirro Gjokë Fufi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kurbin, me vendimin nr.52, datë 5.7.2002, i falet dënimi i mbetur.
26. Artan Besim Xhixha, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.861, datë 29.12.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
27. Dorian Besnik Leci, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.885, datë 11.12.2002, i falet dënimi i mbetur.
28. Luftar Hekuran Pazi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.41, datë 5.6.2003, i falet dënimi i mbetur.
29. Albert Eqerem Xhemollari, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pogradec, me vendimin nr.52, datë 27.7.1998, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
30. Mikel Elmaz Çekrezi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Librazhd, me vendimin nr.32, datë 15.5.2003, i falet dënimi i mbetur.
31. Elton Ibrahim Hasnjoku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.999, datë 13.11.2003, i falet dënimi i mbetur.
32. Alfred Gjini Shyti, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.4, datë 25.1.2001, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
33. Artan Novruz Mema, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.17, datë 3.3.1998, i falet dënimi i mbetur.
34. Donald Maze Rama, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.279, datë 23.3.2003, i falet dënimi i mbetur.
35. Zamir Ukë Murataj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kukës, me vendimin nr.70, datë 31.5.2000, i falet dënimi i mbetur.
36. Petrit Hasan Shehaj, dënuar nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr.523, datë 8.10.2003, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
37. Asim Femi Puci, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.328, datë 5.4.2004, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
38. Dukagjin Xhelal Caka (Bujar Sinani), dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.1, datë 10.5.2001, i falet dënimi i mbetur.
39. Anesti Kristaq Kica, dënuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr.80, datë 14.7.2004, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
40. Sokol Xhelil Skënderi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, me vendimin nr.94, datë 21.12.2000, i falen 4 vjet nga dënimi i mbetur.
41. Gaz (Gazmir) Xhavit Caca, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kavajë, me vendimin nr.25, datë 2.3.2004, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
42. Hamza Abdi Cera, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.558, datë 12.11.2003, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
43. Edmond Abdi Cera, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.558, datë 12.11.2003, i falet dënimi i mbetur.
44. Ardian Dedë Kala, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.32, datë 10.2.2000, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
45. Rifan Fari Nikolli, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.50, datë 10.7.2001, i falet dënimi i mbetur.
46. Skënder Qemal Gurra, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.854, datë 30.12.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
47. Edmond Servet Bakiasi, dënuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.198, datë 23.3.2004, i falet dënimi i mbetur me kusht.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.835, datë 3.12.2004

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR EMERGJENCAT CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 8 e 9 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ministritë dhe institucionet të paraqesin në Këshillin e Ministrave, brenda muajit janar 2005, programet e punës për realizimin e detyrave të përcaktuara në matricën e masave parësore për emergjencat civile në Shqipëri, e cila është pjesë e planit kombëtar për emergjencat civile.
3. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet të cilat kanë funksione dhe detyra specifike në planin kombëtar për emergjencat civile, për zbatimin e këtij plani.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.836, datë 3.12.2004

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT
TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 11 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, si organ vendimmarrës, kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

- Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit	zëvendëskryetar
- Ministri i Ekonomisë	anëtar
- Ministri i Drejtësisë	anëtar
- Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës	anëtar
- Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit	anëtar
- Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit	anëtar
- Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit	anëtar
- Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	anëtar
- Ministri i Mjedisit	anëtar

- një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes anëtar
- një përfaqësues nga Akademia e Shkencave anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit sekretar.

2. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet në rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Anëtarët e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë shpërblehen, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

5. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.627, datë 24.12.1997 “Për krijimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.417, datë 3.9.1999 “Për shpërblimin e punës së anëtarëve të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH).

Neni 2

Organizimi i KRRTRSH-së

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH) është organ vendimmarrës dhe krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KRRTRSH-ja përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari i KRRTRSH-së.

Neni 3

Funksionimi

KRRTRSH-ja kryesohet nga Kryetari dhe, në mungesë e me porosi të tij, nga zëvendëskryetari i KRRTRSH-së.

Kryetari miraton rendin e ditës të propozuar nga zëvendëskryetari i KRRTRSH-së.

KRRTRSH-ja si rregull mbledhet një herë në muaj. Në rastet kur shihet e arsyeshme, kryetari mund të mbledhë KRRTRSH jashtë rradhe.

Njoftimi për mbledhje të KRRTRSH-së bëhet të paktën pesë ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.

KRRTRSH-ja i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij.

Rendi i ditës dhe materiali që do të shqyrtohen në KRRTRSH, u vihet në dispozicion anëtarëve të KRRTRSH-së të paktën pesë ditë para se të bëhet mbledhja.

Rendi i ditës përmban:

- Tematikat që do të trajtohen;

- Datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e KRRTRSH-së:
- Materialin e bashkëlidhur për çdo tematikë që do të shqyrtohet në mbledhje.

KRRTRSH-ja për çështjet që trajton, merr vendime me shumicë votash. Në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit vlen sa dy vota.

Në mbledhjen e KRRTRSH-së, sipas objektivit dhe materialit, marrin pjesë pa të drejtë vote kryetari i KRRT-së së njësisë vendore përkatëse, përfaqësues nga institucione shtetërore të interesuara, autorë të projektit, përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve dhe Shoqata e Ndërtuesve.

KRRTRSH-ja ka vullën e vet.

Neni 4

Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacioni shoqërues

Kërkesa për shqyrtim të materialeve në KRRTRSH, si dhe dokumentacioni përkatës paraqiten zyrtarisht në Sekretarinë Teknike pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nëpërmjet njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, që ka në juridiksion territorin ku është kryer studimi, pas miratimit nga KRRT-të përkatëse.

Në rastin e investimeve publike, mund të paraqitet edhe nga institucionet shtetërore të interesuara, duke u miratuar më parë nga KRRT-ja e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

Kërkesa dhe dokumentacioni përkatës që shoqëron atë, duhet të jetë në përputhje me ligjin nr.8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, me ndryshimet përkatëse dhe vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për urbanistikën” dhe dispozitave ligjore në fuqi, që kanë lidhje me objektin e shqyrtimit.

Sekretaria teknike ka për detyrë të verifikojë paraprakisht që dokumentacioni i materialit që paraqitet për shqyrtim në KRRTRSH duhet të jetë në origjinal, në katër kopje, i firmosur dhe i vulosur nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore, si dhe projektet të jenë të firmosura nga autorët e tyre, sipas licencave.

Kur studimet janë hartuar nga subjekte të huaja, materiali duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni i materialit që paraqitet për shqyrtim në KRRTRSH, duhet të përmbajë:

1. Për të gjitha llojet e studimeve dhe shesheve të ndërtimit, të përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.8405 datë 17. 9.1998 “Për urbanistikën” dhe përkufizimeve në nenin 1 të tij;

- Kërkesa për shqyrtim në KRRTRSH të studimit nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore. Për rastin e investimeve publike, kërkesa mund të bëhet edhe nga institucioni i interesuar shtetëror.

- Vendimi i KRRT-së së njësisë përkatëse të qeverisjes vendore për miratimin e studimit, në të cilin të përcaktohet emërtimi i studimit, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit, pozicioni i zonës së studiuar.

- Studimi urbanistik i miratuar nga KRRT-ja përkatëse dhe i konfirmuar nga Kryetari i KRRT-së, sipas modelit përkatës në rregulloren për urbanistikën me/i; a) një relief të saktë topografik në shkallën 1:500 ose 1:1000 të territorit të studiuar; b) azhurnuar sipas gjendjes ekzistuese, ku të përcaktohen kufijtë e sheshit të ndërtimit dhe përmasat e tyre, si dhe sipërfaqja e sheshit të ndërtimit; c) skema rajonale e vendosjes së zonës së studiuar, si dhe pozicioni kadastral i saj. Materiali të përmbajë: a) projektidenë e objekteve të parashikuara në studim; b) materiale të tjera grafike që shpjegojnë zgjidhjen teknike; c) të dhënat e treguesit të nevojshëm sipas rregullores për urbanistikën, në varësi të llojit të studimit, si dhe pamje të gjendjes ekzistuese të zonës së marrë në studim.

- Projektidea e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të furnizimit me ujë, energji eiektrike, telefoni, ngrohje, kanalizim, si dhe trajtimit të mbeturinave të ngurta urbane.

- Relacioni teknik mbi studimin, në të cilin të jepen të dhëna lidhur me vendndodhjen e zonës së studiuar, lidhjen e tij me studime të kryera e miratuara më parë konform ligjit, të dhëna mbi zgjidhjen urbanistike, sipërfaqet sipas zonimit funksional, objektet e parashikuara dhe përshkrimi i tyre, të dhëna mbi projektin e infrastrukturës inxhinierike dhe lidhjen e saj me infrastrukturën ekzistuese, të dhëna mbi vërtetësinë e pronësisë nga zyra e regjistrimit të pasurive të Paluajtshme ose të dhëna mbi vërtetimin e lëshuar nga seksioni i kadastrës në lidhje me specifikime

kadastrale të parcelës dhe pronësinë e tokës në rast se këto nuk sqarohen nga certifikata e pronësisë.

- Vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit mbi kategorinë e tokës sipas bonitetit, mendim nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, nëse territori është sipërfaqe pyjore.

- Oponenca e Institutit të Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike dhe Ministrisë së Mjedisit për çdo studim.

- Oponenca e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, kur zona e studiuar ndodhet jashtë vijës kufizuese të ndërtimit.

- Oponenca e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kur materiali që do të shqyrtohet në KRRTRSH ka të bëjë me territore në zona të shpallura monument kulture dhe zonave të mbrojtura rreth tyre.

- Oponenca të institucioneve të tjera, që gjykohet nga drejtoria përkatëse në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit se preken direkt ose indirekt nga projekti.

- Oponenca e Drejtorisë së Zhvillimit të Turizmit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, kur studimi është në zonë me përparësi zhvillimi të turizmit.

2. Për të gjitha materialet, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe nenit 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”:

- Kërkesa për shqyrtim në KRRTRSH të materialit nga Policia e Ndërtimit ose këshilli i zgjedhur i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, ose prefekturave përkatëse;

- Argumentimi teknik dhe ligjor për shqyrtimin e kërkesës për shfuqizim të vendimeve të marra nga KRRT-ja e njësisë vendore përkatëse. Dokumentacioni i miratimit të bërë nga KRRT-ja e kësaj njësie.

Neni 5

Sekretaria teknike e KRRTRSH-së

Sekretaria teknike e KRRTRSH-së është organ teknik këshillimor, e cila është krijuar në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe funksion në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit.

Kryetari i sekretarisë teknike të KRRTRSH-së është Zëvendësministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Sekretaria teknike e KRRTRSH-së shqyrton paraprakisht materialet e paraqitura për miratim në KRRTRSH, duke i rekomanduar KRRTRSH-së mendimin teknik nëpërmjet konkluzioneve të saj për secilin material të paraqitur.

Neni 6

Sekretari i KRRTRSH-së

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit është Sekretar i KRRTRSH dhe ka për detyrë:

Të koordinojë dhe të verifikojë nëse materialet e paraqitura për shqyrtim në KRRTRSH janë konform ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, vendimit nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” dhe të dispozitave ligjore në fuqi që kanë lidhje me objektin e shqyrtimit. Nëse nuk janë në përputhje me kërkesat e dispozitave të kërkuara, i kthen ato për plotësim.

- Të koordinojë dhe kontrollojë procedurën administrative sipas kësaj rregulloreje dhe Kodit të Procedurave Administrative për materialet që do të shqyrtohen në KRRTRSH, para dhe pas vënies në dispozicion nga sekretaria teknike e KRRTRSH-së.

- Pas mbledhjes së KRRTRSH-së, përgatit vendimet e KRRTRSH-së për materialet e shqyrtuara e miratuara në KRRTRSH-ja dhe ndjek e koordinon zbatimin e vendimeve të marra.

Neni 7
Vendimmarrja

KRRTRSH-ja shqyrton materialet e paraqitura, jo më vonë se një muaj nga shqyrtimi i tyre në sekretarinë teknike të KRRTRSH-së.

KRRTRSH-ja merr vendime për miratimin e studimeve në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, merr vendime në zbatim të nenit 10 të po këtij ligji dhe vendos për njoftimet e bëra nga Policia e Ndërtimit në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.

Në përfundim të çdo tematike, KRRTRSH-ja vendos:

- miratimin e materialit të paraqitur;
- miratimin me vërejtje për përmirësim;
- shtyrje për shqyrtim në mbledhjen më të afërt;
- mosmiratimin.

Kur KRRTRSH-ja e shtyn çështjen për shqyrtim, me qëllim pasqyrimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve të bëra në mbledhje, njësia vendore përkatëse, së bashku me subjektin e interesuar, brenda 15 ditëve, reflektojnë vërejtjet dhe i paraqesin sipas konkluzioneve të arritura nga KRRTRSH-ja.

Neni 8
Arkivimi i materialit të shqyrtuar në KRRTRSH

Pas konfirmimit nga Kryetari i KRRTRSH-së, studimet shpërndahen në një kopje në institucionet dhe organet shtetërore, që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e tyre, si më poshtë:

- Në Arkivin e Këshillit të Ministrave;
- Në Arkivin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;

Këtu arkivohet edhe gjithë dokumentacioni i materialit të paraqitur për shqyrtim në KRRTRSH;

- Në Sektorin e KRRTRSH-së;
- Në Institutin e Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike;
- Në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, për rastin e studimeve urbanistike, dhe shesheve të ndërtimit;
- Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, për rastin e studimeve urbanistike e shesheve të ndërtimit në territore jashtë vijave kufizuese të ndërtimit;
- Në Drejtorinë e Zhvillimit të Turizmit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, për rastin e studimeve urbanistike dhe shesheve të ndërtimit në zonat me përparësi zhvillimi të turizmit;
- Në njësitë përkatëse të qeverisjes vendore;
- Investitorit ose institucionit shtetëror të interesuar.

VENDIM
Nr.839, datë 17.12.2004

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “RREGULLORJA E SHËRBIMIT TË JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Rregullorja e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”,

që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.331, datë 29.5.2003 i Këshillit të Ministrave “Për kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë në përzgjedhjen për marrjen e gradës “ambasador””, shfuqizohet.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4. Ngarkohet Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE

PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e veprimtarisë së shërbimit të jashtëm sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë, ligji nr.9095).

2. Shërbimi i jashtëm i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe misionet diplomatike e postet konsullore (më poshtë: misionet dhe postet) jashtë vendit.

KREU II

DISPOZITA PËR STATUSIN E NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

3. Në shërbimin e jashtëm kryejnë veprimtari diplomatike dhe konsullore ato drejtori dhe sektorë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, veprimtaria e të cilëve rregullohet mbi bazën e ligjit nr.9095, si dhe misionet dhe postet. Këtu nuk përfshihen drejtoritë dhe sektorët e Ministrisë, veprimtaria e të cilëve përcaktohet në nenin 47 të këtij ligji.

4. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm që zhvillon veprimtari diplomatike dhe konsullore gëzon statusin e diplomatit. Ai është diplomat karriere (më poshtë: diplomati), kur është rekrutuar në shërbimin e jashtëm sipas nenit 13 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (më poshtë: ligji nr.8549) ose ka përfutur statusin e nëpunësit civil sipas dispozitave transitorë të atij ligji.

4.1 Nëpunësi i emëruar në shërbimin e jashtëm në përputhje me nenin 20 paragrafi 2 të ligjit nr. 9095, gëzon statusin e diplomatit për sa kohë ndodhet në shërbimin e jashtëm.

5. Diplomatët gjatë karrierës së tyre fitojnë grada diplomatike ose konsullore.

5.1 Diplomatët, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në postet konsullore jashtë vendit, emërohen sipas gradave konsullore. Paga e tyre caktohet në bazë të gradës diplomatike që mbajnë.

6. Për çdo shtesë ose ndryshim të mundshëm të strukturës së Ministrisë së Punëve të Jashtme përcaktohet statusi i strukturave të reja apo atyre të ndryshuara, si dhe i nëpunësve që punojnë në to, lidhur me të drejtën e tyre për të përfutur statusin e diplomatit.

KREU III

LËVIZJA PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË

7. Lëvizjet paralele dhe ngritjet në detyrë të diplomatit bëhen në funksion të përmirësimit të punës dhe/ose për plotësimin e vendeve vakante.

8. Procedura e lëvizjes paralele/e ngritjes në detyrë të diplomatit mbështetet:

- a) në përzgjedhjen;
 - b) në përputhshmërinë e gradës diplomatike të kandidatit me kërkesat e vendit vakant;
 - c) në vlerësimin vjetor të punës nga eprori direkt;
 - Vlerësimi vjetor i punës së diplomatit “përgjithësisht mjaftueshëm” sipas sistemit të vlerësimit dhe formularit bashkëlidhur kësaj rregulloreje është kusht për fillimin e procedurës së lëvizjes së diplomatit nga detyra që mbulon.
 - E drejta e aplikimit për një vend vakant lind kur kandidati ka marrë vetëm vlerësime “mirë” dhe “shumë mirë”.
 - e) në përvojën individuale të diplomatit aplikuese cila vlerësohet nga pozicionet në të cilat ka shërbyer (brenda ose jashtë vendit, llojshmëria e pozicionit, pozicione në poste drejtuese), përvojat e veçanta, kualifikimet e kryera (ato me karakter diplomatik dhe ato me karakter shkencor), gjuhët e huaja që zotëron, etj.;
 - f) në specifikën e vendit vakant (gjuha e huaj e veçantë, etj.);
 - g) në të qenët i konfirmuar si nëpunës civil.
9. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve nisur nga vlerësimi vjetor i punës së diplomatëve dhe/ose krijimi i një vendi vakant njofton me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm.
- 9.1. Në rastin kur lëvizjet paralele/ngritjet në detyrë bëhen në funksion të përmirësimit të punës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve e njofton Sekretarin e Përgjithshëm brenda datës 15 dhjetor të vitit që është bërë vlerësimi i punës.
- 9.2 Në rastin kur do të plotësohet një vend vakant, njoftimi bëhet brenda 3 ditësh nga krijimi i tij.
10. Sekretari i Përgjithshëm brenda 15 ditësh i paraqet për miratim Ministrin propozimin për fillimin e procedurës për kryerjen e një lëvizjeje paralele/ngritjeje në detyrë dhe/ose për plotësimin e vendit vakant.
11. Ministri jep vendimin 10 ditë nga marrja e propozimit.
- 11.1 Kur Ministri jep miratimin për fillimin e procedurës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm, si dhe drejtorinë ku është shfaqur nevoja për të kryer një lëvizje paralele/ngritjeje në detyrë dhe/ose është hapur një vend vakant, përgatit kriteret specifike për vendin e dhënë mbështetur në parimet dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 8. Pastaj bën shpalljen përkatëse duke përcaktuar afatin e dorëzimit të aplikimeve.
- 11.2 Ministri ka të drejtën të mos e miratojë fillimin e procedurës për kryerjen e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë ose për plotësimin e një vendi vakant. Në këtë rast ai e motivon refuzimin e tij.
12. Diplomatët e interesuar paraqesin kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore brenda 15 ditëve nga shpallja. Ata duhet të përshkruajnë në kërkesë argumentet vetjake për interesin e shprehur dhe kontributin që mund të japin në detyrën e re.
13. Kërkesat mblidhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, e cila studion të dhënat vetjake që ndodhen në dosjet e diplomatëve aplikues dhe bën përzgjedhjen e tyre në bazë të parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në pikën 8 të kësaj rregulloreje.
14. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve brenda 5 ditësh nga përfundimi i afatit të dorëzimit të aplikimeve i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm listën e diplomatëve që kanë aplikuar së bashku me kandidatura të tjera, të cilat u përgjigjen parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në pikën 8 të kësaj Rregulloreje. Ajo e shoqëron të gjithë praktikën me një relacion për secilën kandidaturë.
- 14.1 Kur lëvizja paralele kryhet në funksion të përmirësimit të punës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve i paraqet njëkohësisht Sekretarit të Përgjithshëm edhe propozimin për emërimin që do të marrë diplomati, i cili largohet nga pozicioni i punës. Si rregull, ky nëpunës kalon ose në pozicionin e punës së liruar nga kandidatura fituese, ose në një pozicion tjetër me kualifikim diplomatik më poshtë nga grada e diplomatit që lëviz për shkak të vlerësimit “përgjithësisht mjaftueshëm”.
15. Sekretari i Përgjithshëm përzgjedh tre nga kandidaturat dhe së bashku me propozimin për kandidaturën që e vlerëson më të përshtatshme ia përcjell për miratim Ministrin.

16. Ministri jep miratimin për kandidaturën e propozuar dhe nxjerr urdhrin e emërimit.

16.1 Kur Ministri nuk e miraton kandidaturën e propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm, ai e shoqëron refuzimin me motivacionin përkatës. Në këtë rast, ai emëron një diplomat të zgjedhur nga lista e kandidaturave.

16.2 Përveç urdhrit të emërimit të kandidatit të miratuar, Ministri nxjerr edhe urdhrin e emërimit të diplomatit, i cili liron postin që do të plotësohet me lëvizje paralele/ngritje në detyrë.

17. Vendi vakant i krijuar si rezultat i largimit të një diplomati nga shërbimi i jashtëm plotësohet me diplomatë aplikues që përmbushin kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.324, datë 21.5.2004, si dhe në pikën 8 të kësaj rregulloreje.

17.1 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve njofton Departamentin e Administratës Publike për të filluar procedurat për pranimin e një nëpunësi të ri në shërbimin e jashtëm, në rastin kur vendi vakant nuk ka kriter për gradë diplomatike.

KREU IV EMËRIMI NË MISIONE/POSTE

18. Procedura për emërim në mision/post bëhet sipas parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në pikën 8 të kësaj Rregulloreje.

18.1 Diplomati nuk mund të emërohet në një mision/post, kur shtetësia e tij apo e bashkëshortes përkohë me atë të vendit ku ndodhet misioni/posti.

19. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve si rregull bën planifikimin njëvjeçar të emërimeve në misione/poste dhe ia paraqet për vlerësim Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë se data 15 dhjetor e çdo viti listën e vendeve vakante në misione/poste për vitin pasardhës.

20. Sekretari i Përgjithshëm ia paraqet për miratim Ministrit, jo më vonë se data 10 janar, listën e vendeve vakante të shoqëruar me propozimin e vet për fillimin e procedurës për plotësimin e secilit prej tyre.

21. Ministri jep miratimin brenda 15 ditësh.

21.1 Në rast se Ministri nuk e miraton fillimin e procedurës për plotësimin e një vendi vakant, ai përcakton në motivacionin e tij edhe kohën kur do të fillojë procedura.

22. Pas miratimit të listës nga Ministri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në konsultim me drejtorinë që mbulon misionin/postin ku është hapur vendi vakant, përgatit të dhënat dhe kushtet specifike për çdo vend vakant dhe bën shpalljen e vendeve vakante brenda muajit janar.

23. Procedura e mëtejshme e emërimeve është e njëjtë me sa është përcaktuar në pikat 12 - 16 të kësaj rregulloreje.

24. Urdhri i Ministrit për emërimet e diplomatëve në misione/poste del brenda muajit mars të çdo viti.

24.1 Në raste të veçanta, me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme, mund të bëhen emërime edhe jashtë këtij caku kohor.

25. Përgatitja për marrjen e detyrës e diplomatit të emëruar në mision/post zgjat si rregull 1 muaj nga data e marrjes së miratimit të palës pritëse.

26. Diplomati i emëruar përpara paraqitjes në këtë detyrë është i detyruar:

a) të dorëzojë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve procesverbalin e dorëzimit të pajisjeve në ngarkim, të dosjeve dhe praktikave diplomatike ose konsullore që ai ka pasur në ndjekje, si dhe të materialeve në kompjuter. Procesverbali duhet të jetë i nënshkruar nga eprori direkt.

b) të hartojë, në bashkëpunim me drejtorinë që mbulon misionin/postin ku ai është emëruar, si dhe me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, planin e punës për përgatitjen për detyrën e re. Në planin e punës, i cili miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm, parashikohen kontaktet me drejtoritë e MPJ-së dhe, nëse gjykohet e arsyeshme, me dikastere apo institucione të ndryshme të vendit.

c) të dorëzojë në mbarim të përgatitjeve pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve kopjen e procesverbalit të nënshkruar nga titullarët e drejtorive, ku ka kryer përgatitjen, dhe titullimet e informacioneve që ka hartuar pas takimeve nëpër institucionet që ka vizituar.

26.1 Procesverbalet mbi përfundimin e përgatitjes së diplomatit për marrjen e detyrës së re, së bashku me kopjen e urdhrat të emërimit depozitohen në dosjen vetjake të diplomatit.

27. Rregullat dhe procedura për emërimin e diplomatit në mision/post vlejné edhe për emërimin e personelit teknik të shërbimit të jashtëm me përjashtim të sa është përcaktuar në pikat 22, 23, 25, 26 b dhe c, 26.1.

KREU V TRANSFERIMI OSE KTHIMI NGA MISIONI/POSTI

28. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, njëkohësisht me planifikimin e emërimeve, kryen edhe planifikimin e transferimeve dhe harton listën e kthimeve të mundshme të diplomatëve nga misionet/postet. Ajo i paraqet për vlerësim Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë se data 15 dhjetor e çdo viti praktikën e plotë për vitin e ardhshëm.

28.1 Kushti bazë për përcaktimin e nevojës për një kthim të mundshëm është vlerësimi i punës së diplomatit në mision/post me karakteristikën “përgjithësisht mjaftueshëm”.

29. Sekretari i Përgjithshëm ia paraqet për miratim Ministrit jo më vonë se data 10 janar listën e transferimeve të planifikuara ose kthimeve të mundshme shoqëruar me propozimin e vet për fillimin e procedurës.

30. Ministri jep miratim dhe nxjerr urdhrat përkatëse brenda datës 15 shkurt. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve u bën njoftim menjëherë misioneve/posteve dhe personave të interesuar.

31. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve përgatit brenda datës 10 maj listën e vendeve vakante në Ministrinë e Punëve të Jashtme, që parashikohet të zënë diplomatët që kanë marrë urdhrin e transferimit dhe propozimin konkret për plotësimin e secilit prej këtyre vendeve, pastaj ia kalon për vlerësim Sekretarit të Përgjithshëm.

31.1 Kriteret për hartimin e propozimeve janë të njëjta me ato që janë përcaktuar në pikën 8 të kësaj rregulloreje.

32. Sekretari i Përgjithshëm, jo më vonë se data 15 maj, i paraqet për miratim Ministrit listën e vendeve vakante dhe të propozimeve konkrete për plotësimin e secilit prej tyre, së bashku me sugjerimet e veta.

33. Ministri jep miratimin brenda 10 ditësh. Në rast se Ministri nuk miraton ndonjërin nga propozimet e paraqitura nga Sekretari i Përgjithshëm, ai e shoqëron refuzimin me motivacionin përkatës. Në këtë rast, ai bën ndryshimin përkatës në emërim në përputhje me sa është përcaktuar në pikën 8 të kësaj rregulloreje.

34. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve njofton shefin e misionit/postit dhe diplomatin e interesuar një muaj përpara datës së transferimit të diplomatit duke komunikuar edhe emërimin e tij në detyrën e re në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

35. Në përfundim të shërbimit të diplomatit në mision/post shefi i misionit/postit, bën vlerësimin me shkrim të rezultateve të përgjithshme në punë të diplomatit dhe plotëson procesverbalin mbi përmbushjen nga ana e diplomatit të transferuar të detyrimeve të përcaktuara në pikën 36, pastaj i dërgon ato në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

36. Diplomati të cilit i është komunikuar urdhri dhe data e transferimit/kthimit nga misioni/posti, pavarësisht nga grada dhe detyra, përpara kthimit në atdhe është i detyruar:

a) të nënshkruajë procesverbalin e dorëzimit të pajisjeve në ngarkim, të dosjeve dhe praktikave diplomatike e konsullore që ai mban në ndjekje, të praktikave të mbyllura, që janë krijuar nga pozicioni i tij i punës dhe që ende nuk janë dorëzuar, si dhe të materialeve në kompjuter.

b) të likuadojë të gjitha detyrimet financiare me misionin/postin, si dhe me shtetin ku ka ushtruar detyrën.

c) të dorëzojë të gjitha dokumentet e lëshuara nga shteti pritës mbi identitetin individual dhe të familjarëve në ngarkim, të cilat i ka përfutur mbi bazën e statusit të punonjësit të misionit/postit, si dhe dokumentacionin e autoveturës/autoveturave vetjake sipas rregullave dhe procedurave protokollare në fuqi të shtetit ku ka ushtruar detyrën.

37. Diplomati është i detyruar të paraqitet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe

Shërbimeve jo me vonë se tri ditë nga kthimi i tij në atdhe. Në këtë rast ai dorëzon:

- vlerësimin e punës nga shefi i misionit/postit;
- kopjen e procesverbalit të përpiluar dhe nënshkruar nga shefi i misionit/postit, që vërteton përmbushjen korrekte të të gjitha detyrimeve të tij të parashikuara në pikën 36.

38. Diplomati ka të drejtën të njihet, kur është kthyer në atdhe, me vlerësimin e punës së tij që ka bërë shefi i misionit/postit dhe të dorëzojë te Sekretari i Përgjithshëm brenda tri ditësh ankesë me shkrim për këtë vlerësim.

38.1 Vendimi i marrë nga Sekretari i Përgjithshëm së bashku me ankesën me shkrim të diplomatit i bashkëlidhen vlerësimit të bërë nga shefi i misionit/postit dhe vendosen në dosjen vetjake të diplomatit.

39. Rregullat dhe procedura për transferimin ose kthimin e diplomatit në mision/post vlejné edhe për transferimin ose kthimin e personelit teknik me përjashtim të sa përcaktohet në pikat 31, 3.11, 32, 33.

KREU VI PARIMET E KRIJIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË GRADAVE DHE DISIPLINËS

40. Komisioni i Gradave dhe Disiplinës (më poshtë: Komisioni) është organ i Ministrisë së Punëve të Jashtme, që shqyrton dhe merr vendim për kërkesat e diplomatëve për ngritje në gradë, ankesat e nëpunësve të shërbimit të jashtëm, ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori direkt i tyre, dhe për rastet e shkeljeve të rënda.

41. Komisioni ngrihet me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme.

41.1 Urdhri i ngritjes së Komisionit përcakton përbërjen e Komisionit dhe datën e mbajtjes së seancës së punës. Ai nënshkruhet ditën e mbajtjes së seancës së punës të Komisionit dhe u bëhet i njohur të gjithë punonjësve të shërbimit të jashtëm nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

42. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarësh, nga të cilët dy të përhershëm: Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

42.1 Tre anëtarët jo të përhershëm zgjidhen nga radhët e diplomatëve me gradën më të lartë dhe janë të tillë vetëm për një sesion pune të Komisionit.

42.2 Anëtari i Komisionit nuk mund të zgjidhet nga radhët e diplomatëve që kanë paraqitur kërkesë për ngritje në gradë ose ankesë për masën disiplinore të marrë nga eprori direkt, ose ndaj të cilëve do të merret në shqyrtim kërkesa për marrjen e një mase disiplinore.

43. Sekretari i Përgjithshëm është kryetar i Komisionit.

44. Komisioni mblidhet në një sesion të vetëm dhe si rregull funksionon brenda një seance pune.

44.1 Komisioni mblidhet, si rregull, brenda datës 15 të çdo muaji dhe mban titullimin e muajit përkatës.

44.2 Për shqyrtimin e kërkesave për dhënie të gradave diplomatike, Komisioni mblidhet vetëm një herë në muaj. Ai merr në shqyrtim të gjitha kërkesat që plotësojnë brenda atij muaji kushtin kohor të vjetërsisë së nevojshme për gradën e kërkuar në përputhje me sa është përcaktuar në nenin 36 të ligjit nr.9095 dhe në pikat 60.1 a, 62 e 63.1-3 të kësaj rregulloreje.

44.3 Për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori direkt i tyre, dhe për rastet e shkeljeve të rënda, Komisioni mblidhet edhe në sesion jashtë radhe. Në këto raste, përbërja e tij është ajo e muajit të radhës.

45. Vendi i seancës së punës së Komisionit është salla e mbledhjeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

46. Sesioni i Komisionit zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve, të cilët kanë të drejtën e votës pro ose kundër. Vota abstenuese nuk lejohet.

47. Funksionet e sekretarisë do të kryhen nga specialisti i sektorit të personelit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, i cili përgatit dokumentacionin për mbledhjen e Komisionit, mban procesverbalin e zhvillimit të saj dhe mbush formularin e vendimit.

KREU VII

FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË GRADAVE DHE DISIPLINËS

48. Seanca e punës fillon me leximin nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të urdhrit të Ministrit për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit dhe verifikimin e përbërjes së plotë të Komisionit.

49. Pas verifikimit të përbërjes së Komisionit, Sekretari i Përgjithshëm verifikon dokumentacionin e seancës.

49.1. Me “dokumentacion të seancës” kuptohet dosja që do të shqyrtohet nga Komisioni. Secili nga anëtarët ka në dispozicion një kopje të saj.

49.2 Dokumentacioni për kërkesat e ngritjes në gradë përmban:

a) kërkesën me shkrim të diplomatëve kërkuar, shoqëruar me fishën përkatëse të mbushur prej tyre.

b) fishën e plotësuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe të kundërfirmuar nga Sekretari i Përgjithshëm, e cila përmban:

b.1 të dhënat vetjake të diplomatit kërkuar;

b.2 të dhënat e përvojës së tij në punë (brenda dhe jashtë shërbimit të jashtëm);

b.3 të dhënat e kualifikimeve të ndryshme;

b.4 vlerësimin e dy viteve të fundit të diplomatit kërkuar;

b.5 gradën që diplomati kërkuar mban dhe datën e dhënies së saj;

b.6 formularin e vlerësimit;

b.7 formularin e vendimit.

49.3 Dokumentacioni për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm, ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori direkt i tyre, përmban:

a) ankesën e nëpunësit të shërbimit të jashtëm;

b) vendimin e eprorit direkt për dhënien e masës disiplinore;

c) akte e dokumente të tjera lidhur me shkeljen.

49.4 Dokumentacioni për rastet e shkeljeve të rënda përmban:

a) kërkesën drejtuar Komisionit për masë disiplinore ndaj nëpunësit të shërbimit të jashtëm;

b) akte e dokumente të tjera lidhur me shkeljen.

49.5 Format i fishës së plotësuar nga diplomatët, i fishës së plotësuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, i formularit të vlerësimit dhe të formularit të vendimit përpilohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm.

50. Gjatë shqyrtimit të kërkesave për marrjen e masave disiplinore apo në rastet kur shqyrtohen ankesat e nëpunësit të shërbimit të jashtëm, kur ndaj tij është marrë masë disiplinore nga eprori direkt, diplomati është i pranishëm dhe ka të drejtën e dëgjimit e të mbrojtjes. Ai gëzon të drejtën për të paraqitur para Komisionit përfaqësuesin e vet ligjor.

50.1 Secili nga anëtarët e Komisionit ka të drejtën t'i drejtojë diplomatit nën proces ose përfaqësuesit të tij ligjor pyetje rreth çështjes që shqyrtohet.

51. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, çdo anëtar i Komisionit shënon në formularin e vendimit, në vendin e caktuar për bërë emrit të çdo kandidati, vlerësimin e tij duke vënë shënimin “dakord” ose “kundër” në rastet kur shqyrtohet kërkesë për dhënie të gradës ose ankesë ndaj masës disiplinore. Në rastet e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, çdo anëtar, kur voton në favor të dhënies së masës disiplinore, duhet të përcaktojë edhe llojin e saj.

51.1 Në fund anëtar i Komisionit nënshkruan formularin e vlerësimit, plotëson (me shkrim dore) motivacionin përkatës dhe ia dorëzon dosjen Sekretarit të Përgjithshëm.

52. Sekretari i Përgjithshëm shqyrton dosjet e punës të anëtarëve të Komisionit dhe lexon vlerësimet e tyre. Mbi bazën e tyre ai shpall vendimin e Komisionit.

53. Vendimi i Komisionit merret me shumicë të cilësuar të jo më pak se katër prej anëtarëve të tij dhe i përcillet për miratim Ministrit brenda ditës së zhvillimit të sesionit.

53.1 Në rast se gjatë shqyrtimit të një ankese ndaj masës disiplinore ose të një propozimi për marrjen e një mase të rëndë disiplinore nuk arrihet shumica e cilësuar, atëherë konsiderohet si

vendim propozimi që ka mbështetjen e shumicës së thjeshtë, kur në këtë shumicë përfshihet edhe vota e Sekretarit të Përgjithshëm.

53.2 Në rast se Komisioni vendos që propozimi i eprorit të drejtpërdrejtë për marrjen e një mase të rëndë disiplinore nuk është i argumentuar, eprori direkt fillon procedurën për marrjen e masës së lehtë disiplinore një ditë pas daljes së urdhrit të Ministrit sipas përcaktimit të bërë në pikën 56.1 të kësaj rregulloreje.

53.3 Në rast se Komisioni vendos që masa disiplinore e marrë nga eprori direkt ndaj nëpunësit të shërbimit të jashtëm është e argumentuar, këtij të fundit i lind e drejta të vazhdojë procedurën e ankimit pranë Komisionit të Shërbimit Civil, një ditë pas daljes së urdhrit të Ministrit sipas përcaktimit të bërë në pikën 56.1 të kësaj rregulloreje.

54. Në mbarim të seancës së punës së Komisionit, specialisti i sektorit të personelit përpilon procesverbalin e seancës.

54.1 Procesverbali përmban këto të dhëna:

a) datën e zhvillimit të seancës, përbërjen dhe drejtimin e Komisionit;
b) procedurën e punimeve. Konkretisht: 1) shqyrtimin paraprak të dokumentacionit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm; 2) shqyrtimin e dosjes së punës nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe mbushjen nga ana e tyre të formularëve të vlerësimit dhe të formularit të vendimit; 3) leximin përfundimtar të dosjeve të punës të anëtarëve të Komisionit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm dhe shpalljen prej tij të vendimit;

c) tekstin e plotë të vendimit.

54.2 Procesverbali i seancës nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

55. Sekretari i Përgjithshëm i dorëzon Ministrit brenda ditës dokumentacionin e plotë të sesionit të Komisionit së bashku me procesverbalin e seancës.

56. Ministri shqyrton brenda 72 orësh dokumentacionin dhe jep vendimin me urdhër të veçantë për secilin diplomat që gradohet.

56.1 Brenda të njëjtit afat kohor të përcaktuar në pikën 56 të kësaj rregulloreje, Ministri jep vendimin për çdo masë të rëndë disiplinore ose për çdo ankesë të një nëpunësi të shërbimit të jashtëm për masën disiplinore të marrë nga eprori direkt.

56.2 Vendimi i Ministrit mund të jetë i ndryshëm nga ai i Komisionit të Gradave dhe Disiplinës. Në këtë rast ai shoqërohet me motivacionin përkatës.

57. Diplomati e fiton gradën me nënshkrimin e urdhrin nga Ministri, ndërsa efektet financiare nisin nga data 1 e muajit pasardhës.

58. Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ua bën të ditur urdhrin e Ministrit Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësve të shërbimit të jashtëm të interesuar, eprorëve e tyre direkt dhe, kur ka efekte financiare, Drejtorisë së Financës.

59. Kopje e urdhrin depozitohet në dosjen vetjake të diplomatit.

KREU VIII

PARIMET DHE KRITERET PËR DHËNIEN E GRADAVE DIPLOMATIKE

Parimet

60. Sistemi i gradave diplomatike dhe konsullore:

a) ka karakter unik, pasi edhe sistemi i gradave si shprehje e karrierës është unik;
b) mbështetet në frymën e përgjithshme të legjislacionit për pagat dhe sigurimet shoqërore, ku vlerësohet vjetërsia në punë për efekt page.

60.1 Kërkesa e diplomatit do të merret në shqyrtim, pasi paraprakisht të jetë verifikuar plotësimi prej tij i këtyre kushteve:

a) të ketë mbushur afatin kohor të përcaktuar në nenin 38 të ligjit nr.9095, si dhe në pikat 63. 1-3 të kësaj rregulloreje;

b) dy vitet e fundit vlerësimi vjetor i punës të mos ketë qenë më i ulët se niveli “mirë”;

c) të ketë arritur rezultate pozitive të vërtetuara me dëshmitë përkatëse në kualifikimet ku ka marrë pjesë.

Kriteret

61. Sistemi i gradave diplomatike dhe konsullore mbështetet në kriteret themelore e specifike.

62. Kriteret themelore vlejné për dhënien e të gjitha gradave. Ato janë:

1. Vjetërsia në shërbimin e jashtëm.
2. Kualifikimet diplomatike, shkencore, etj.

Si kualifikime do të vlerësohen:

2.1 Ato me karakter diplomatik.

Kualifikimet diplomatike në tërësinë e tyre nuk do të njihen me tepër se 1 vit në pikëpamje të vjetërsisë në punë në shërbimin e jashtëm.

2.2 Ato me karakter shkencor.

Titulli “Profesor” dhe grada “Doktor shkencash” do të njihet përkatësisht për 4 dhe 2 vjet vjetërsi në shërbimin e jashtëm. Dëshmia e studimeve për “master” njihet për 1 vit vjetërsi në shërbimin e jashtëm:

2.3 Njohjet e gjuhëve të huaja:

a) Gjuha e huaj (përveç anglishtes) e mbrojtur me provim pasuniversitar me notën 8 e lart njihet për 1 vit nga pikëpamja e vjetërsisë në shërbimin e jashtëm.

b) Gjuha e huaj që përdoret si gjuhë pune njihet për 6 muaj nga pikëpamja e vjetërsisë në shërbim.

3. Vlerësimi i punës.

4. Mospasja e masës disiplinore të parashikuar në pikën 72, a.

63. Për dhënien e gradave “ministër këshilltar”, “ministër fuqplotë”, “ambasador” ndiqet edhe kriteri specifik i vjetërsisë në funksione drejtuese.

Për këto arsye:

1. Gradat e larta “ministër këshilltar”, “ministër fuqplotë” dhe “ambasador” jepen vetëm mbi bazën e përvojës në poste drejtuese në shërbimin e jashtëm. Njësia bazë për përlllogaritjet e krahasuara të vjetërsisë në poste drejtuese merret viti i punës në postin “drejtor drejtorie” ose “shef misioni diplomatik me titull “ambasador”” (më poshtë: “ambasador”).

2. Vjetërsia e diplomatit në postin e “shefit të postit konsullor” dhe të “të ngarkuarit me punë” llogaritet në raport 1:0,9 me vjetërsinë në postin “drejtor drejtorie” ose “ambasador”. Vjetërsia në postin “shef sektori” llogaritet në raport 1:0,75 me vjetërsinë në postin “drejtor drejtorie” ose “ambasador”.

3. Periudha në punë e diplomatit si anëtar i Kabinetit të Ministrit llogaritet si vjetërsi në post drejtues në raport 1:1 për drejtorin e Kabinetit dhe 1:0,9 për këshilltarin e brendshëm kundrejt vjetërsisë si drejtor drejtorie ose “ambasador”.

4. Vjetërsia në punë e diplomatit si këshilltar diplomatik i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit llogaritet si vjetërsi në post drejtues në raport 1:1 kundrejt vjetërsisë si “drejtor drejtorie ose “ambasador” dhe në raport 1:0,8, kur është këshilltar diplomatik i një anëtari tjetër të qeverisë.

5. Vjetërsia e diplomatit në poste të tilla si shef posti konsullor, i ngarkuar me punë, këshilltar i Kabinetit të Ministrit, shef sektori, si dhe si këshilltar diplomatik i një anëtari qeverie nuk mund të përlllogaritet për efekt të vjetërsisë në post drejtues në masë më të madhe se 20% të periudhës efektive të shërbimit si “drejtor drejtorie” ose “ambasador”.

63.1 Grada “ministër këshilltar” i jepet diplomatit:

a) që mban prej 2,5 vjetësh gradën “këshilltar”;

b) që ka një përvojë prej 2,5 vjetësh në post drejtues “drejtor drejtorie” e lart, përfshirë këtu periudhat në poste të tjera të larta sipas përcaktimeve të pikës 63;

c) që ka marrë dy vitet e fundit vlerësim vjetor të punës jo më të ulët se “mirë” në të gjitha elementet specifike të rezultateve të punës.

63.2 Grada “ministër fuqplotë” i jepet diplomatit:

a) që mban prej 2,5 vjetësh gradën “ministër këshilltar”;

b) që ka një përvojë prej 5 vjetësh në post drejtues “drejtor drejtorie” e lart, përfshirë këtu periudhat në poste të tjera të larta sipas përcaktimeve të pikës 63;

c) që ka marrë dy vitet e fundit vlerësim vjetor të punës jo më të ulët se “mirë” në të gjitha elementet specifike të rezultateve të punës.

63.3 Plotëson kushtet për marrjen e gradës “ambasador” diplomati:

- a) që ka gradën “ministër fuqplotë”;
- b) që ka kryer të paktën një mandat të rregullt në postin e ambasadorit, në përputhje me përcaktimin e nenit 37 paragrafit 4 të ligjit nr.9095. Me mandat të rregullt kuptohet të qëndruarit në detyrën e ambasadorit për një periudhë jo më të vogël se 2 vjet;
- c) që ka jo më pak se 25 vjet vjetërsi të përgjithshme në punë;
- d) që ka marrë vlerësime maksimale për rezultatet në punë.

KREU IX

PËRGJEGJËSIA E DIPLOMATIT, SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

64. Diplomati mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë, korrektësinë dhe saktësinë e veprimeve të tij gjatë ushtrimit të detyrës. Ndaj diplomatit merren masa disiplinore për moskryerjen e detyrave pa shkaqe të arsyeshme dhe sjellje që bien ndesh me rregullat e etikës, për dëmtim të pasurisë apo krijimin e mundësive dhe rrezikut për një dëmtim të tillë, për vepra apo veprime të kryera në punë që cenojnë figurën e tij etiko-morale ose cenim të imazhit të vendit, për shkelje të akteve ligjore e nënligjore.

65. Shkeljet në detyrë kategorizohen në të lehta dhe të rënda.

66. Konsiderohen shkelje të lehta, por pa u kufizuar vetëm në to:

- a) Shkelja nga nëpunësi të disiplinës formale lidhur me respektimin dhe zbatimin e orarit të punës;
- b) qëndrimi dhe sjellja e parregullt etike, morale dhe profesionale në marrëdhëniet me kolegët, eprorët dhe publikun, kur nuk ka sjellë pasoja të rënda;
- c) moszbatimi i urdhrave dhe udhëzimeve të eprorëve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e ngarkuara, si dhe mosrespektimi i afateve të caktuara për realizimin e detyrave;
- d) shpërdorimi me dashje ose nga pakujdesia i pasurisë shtetërore, kur pasojat nuk janë të rëndësishme.

66.1 Masa disiplinore për shkelje të lehta të kryera nga diplomati në Ministrinë e Punëve të Jashtme jepet nga eprori direkt, kurse për diplomatin e misionit/postit masa disiplinore jepet nga shefi i misionit/postit.

66.2 Vendimi i marrë nga eprori direkt mund të ankimohet pranë Komisionit. Kur ankuesi nuk është dakord me vendimin e Komisionit, mund të ankohet pranë Komisionit të Shërbimit Civil.

66.3. Llojet e masave disiplinore për shkelje të lehta janë:

- a) këshillim,
- b) vërejtje me shkrim.

67. Konsiderohen shkelje të rënda, por pa u kufizuar vetëm në to:

- a) kryerja në mënyrë të përsëritur e shkeljeve të konsideruara të lehta;
- b) qëndrimet apo deklaratimet e nëpunësit në funksion të statusit dhe pozicionit të tij, të cilat cenojnë imazhin e Republikës së Shqipërisë dhe politikën e saj të jashtme në marrëdhëniet me shtete, organizata apo institucione të tjera ndërkombëtare;
- c) shpërdorimi i të drejtave dhe privilegjeve që përfiton nga statusi i nëpunësit të shërbimit të jashtëm në përgjithësi dhe ai diplomatik në veçanti;
- d) kryerja e veprimtarive që nuk kanë lidhje me detyrën e diplomatit;
- e) qëndrimi dhe sjellja e parregullt etike, morale dhe profesionale në marrëdhëniet me kolegët, eprorët dhe publikun, kur ka sjellë pasoja të rënda;
- f) braktisja e detyrës;
- g) shpërdorime në administrimin e të ardhurave të shtetit dhe të pasurisë shtetërore, kur kanë ardhur pasoja ose është krijuar mundësia e ardhjes së pasojave të rënda;
- h) mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në pikën 36 të kësaj rregulloreje;
- i) shkelja e detyrave të përcaktuara për nëpunësin civil në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe ato që i përkasin nëpunësit të shërbimit të jashtëm, sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit

n.9095, të cilat vlerësohen si shkelje të rënda.

68. Rastet e shkeljeve të rënda të kryera nga diplomatët shqyrtohen nga Komisioni, i cili i propozon Ministrit të Punëve të Jashtme marrjen e masës disiplinore për shkeljen e kryer.

69. Urdhri i Ministrit për dhënien e masës disiplinore mund të ankimohet në Komisionin e Shërbimit Civil brenda 30 ditëve pune nga komunikimi i urdhrit.

70. Llojet e masave disiplinore për shkeljet e rënda janë:

- a) Pezullimi deri në 2 vjet nga e drejta e ngritjes në gradë;
- b) Pezullimi deri në 2 vjet nga e drejta e ngritjes në detyrë;
- c) Kalimi në një funksion më të ulët;
- d) Largimi nga shërbimi i jashtëm.

70.1 Masa disiplinore “Largimi nga shërbimi i jashtëm” është e barasvlefshme me masën disiplinore “Largimi nga shërbimi civil” dhe për të ndiqen të gjitha procedurat e parashikuara në aktet ligjore në fuqi.

KREU X

PROCEDURA E DHËNIES SË MASËS DISIPLINORE DHE SHLYERJA E SAJ

71. Shqyrtimi i shkeljeve të lehta është kompetencë e eprorit të drejtpërdrejtë të diplomatit që ka kryer shkeljen.

72. Ecuria disiplinore për masat e shkeljeve të lehta fillon nga eprori direkt i diplomatit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim drejtuar atij nga çdo organ apo person i interesuar.

72.1 Kur eprori direkt vendos të fillojë ecurinë disiplinore për vartësin e tij, duhet që procedurat t'i kryejë me ndihmën e specialistëve të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

73. Kërkesa për dhënien e masës disiplinore duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të jetë me shkrim;
- b) të identifikojë diplomatin, që pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore.
- c) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

74. Kur eprori direkt vendos fillimin e ecurisë disiplinore, njofton menjëherë me shkrim diplomatin:

- a) për veprimin konkret, që ai pretendon se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij;
- b) për të drejtën që ka diplomati për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar, afatin e fundit të paraqitjes së sqarimit, sipas afateve të përcaktuara në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”;
- c) për të drejtën e diplomatit që të dëgjohet ai vetë ose me përfaqësues ligjor dhe për të paraqitur dëshmitarë;
- d) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më vonë se 8 ditë nga marrja e njoftimit.

75. Eprori direkt, pasi ka zbatuar procedurat e përshkruara më lart dhe ka dëgjuar diplomatin a përfaqësuesin e tij ligjor ose ka vënë në dukje me shkrim mosparaqitjen e tij, megjithë njoftimin e marrë:

- a) Vendos marrjen e masës disiplinore, kur vëren se është kryer një shkelje e lehtë
- b) Vendos ndërprerjen e ecurisë disiplinore, kur vëren se:
 - 1. veprimi apo mosveprimi i diplomatit nuk përbën shkelje disiplinore, siç ishte pretenduar;
 - 2. veprimi apo mosveprimi nuk është kryer nga diplomati, ndaj të cilit është filluar procedura për ecurinë e masës disiplinore.
- c) Vë në dijeni Komisionin.

75. 1 Shqyrtimi i shkeljes së rëndë bëhet nga Komisioni.

75.2 Ecuria disiplinore për masat e shkeljeve të rënda fillon nga eprori direkt i diplomatit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim drejtuar atij nga çdo organ apo person i interesuar dhe kryhet në të njëjtën mënyrë dhe afat sipas procedurave të parashikuara për dhënien e masave për shkeljet e lehta.

75.3 Masa disiplinore për shkelje të rënda jepet nga Ministri me propozimin e Komisionit.

76. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë ose propozimi i Komisionit për marrjen e masës disiplinore përmban:

- a) organin që ka marrë vendimin;
- b) identifikimin e diplomatit, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore;
- c) masën e marrë;
- d) shkeljen faktike;
- e) bazën ligjore;
- f) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë marrë parasysh për caktimin e tij;
- g) datën e hyrjes në fuqi të vendimit.
- h) të drejtën për t'u ankuar ndaj këtij vendimi, afatin në të cilin duhet të paraqitet ky ankim dhe organin përgjegjës për zgjidhjen e tij.

77. Për një shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

78. Masa disiplinore vendoset në dosjen vetjake të diplomatit.

79. Masa disiplinore mund të shlyhet, në qoftë se brenda një viti nga dita e dhënies së saj për shkeljet e lehta dhe brenda 2 vjetësh nga dita e dhënies së masave të parashikuara në pikën 70, a, b dhe c ndaj diplomatit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masa disiplinore e shlyer hiqet nga dosja vetjake.

KREU XI HUMBJA E STATUSIT TË DIPLOMATIT

80. Diplomati e humbet statusin në këtë shërbim dhe nuk mund të përfitojë prej tij:

a) Kur në mënyrë vullnetare i paraqet eprorit të drejtpërdrejtë dorëheqje me shkrim nga shërbimi i jashtëm. Në dorëheqje parashitohen arsyet dhe data e largimit, e cila duhet të jetë jo më afër se 15 ditë nga data e paraqitjes së dorëheqjes. Eprori direkt, pasi diskuton me diplomatin arsyet për dorëheqjen dhe arrin në përfundimin që vendimi është i pakthyeshëm, bën shënimin përkatës në dorëheqjen e diplomatit dhe ia përcjell atë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, e cila bën shënimet në dosjen vetjake të diplomatit dhe njoftimet përkatëse.

b) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprave penale. Në rastet kur ndaj diplomatit fillohen nga organet kompetente procedurat ligjore për hetim për vepra penale, zbatohet procedura e pezullimit nga puna të diplomatit. Me marrjen e njoftimit për fillimin e procedimit penal, eprori direkt kërkon konfirmimin nga organet kompetente. Konfirmimi me shkrim për fillimin e ndjekjes penale të diplomatit, pavarësisht nga masa që është marrë ndaj tij, përbën detyrim ligjor për eprorin e drejtpërdrejtë për të kërkuar pezullimin nga detyra të diplomatit. Vendimi i formës së prerë i gjykatës kompetente, që jep dënimin me heqje lirie të diplomatit, sjell si pasojë largimin e këtij nga shërbimi i jashtëm. Në rastet kur çështja pushohet nga prokuroria ose kur me vendim të formës së prerë diplomati fiton pafajësinë, ai rifiton të gjitha të drejtat e pezulluara.

c) Kur kryen shkelje të rëndë të parashikuara në këtë rregullore, për të cilat merret masa disiplinore "Largimi nga shërbimi i jashtëm".

d) Kur vërtetohet paaftësia e tij profesionale për të kryer detyrat e caktuara. Paaftësia profesionale dëshmohet në dy vlerësimet vjetore negative të njëpasnjëshme të punës që i bëhen nga eprori i drejtpërdrejtë. Diplomati që në mënyrë të vazhdueshme paraqet probleme dhe mangësi të aftësive profesionale për të përballuar kërkesat e pozicionit të punës, duhet t'i tërhiqet vëmendja. Ai duhet të informohet në detaje për kërkesat dhe përgjegjësitë e pozicionit të punës, për mangësitë e konstatuara dhe për shqetësimet e krijuara si rezultat i paaftësive të tij profesionale gjatë kryerjes së detyrës.

e) Kur vërtetohet paaftësia e tij shëndetësore për kryerjen e detyrës diplomatike.

f) Kur braktis detyrën.

g) Në rastin e daljes në pension. Si rregull diplomati njoftohet 1 muaj përpara.

h) Kur ndahet nga jeta.

KREU XII
DIPLOMATË NË DISPOZICION TË MINISTRIT, MARRJA E PERSONAVE
JASHTË SHËRBIMIT TË JASHTËM, GRUPET E PUNËS

81. Diplomati mund të vihet në dispozicion të Ministrit të Punëve të Jashtme për një periudhë prej jo më shumë se një vit. Pas kësaj kohe ai emërohet detyrimisht në një vend tjetër në Ministrinë e Punëve të Jashtme ose në përfaqësitë diplomatike.

81.1 Diplomati që vihet në dispozicion të Ministrit të Punëve të Jashtme ka si rregull gradë diplomatike jo më të ulët se “këshilltar”.

82. Emërimi i diplomatit në dispozicion të Ministrit dhe largimi prej tij bëhet me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme. Diplomatit në dispozicion të Ministrit mund t’i ngarkohen detyra të këshilltarit për çështje të politikës së jashtme ose detyra në organizma ndërkombëtarë, në kongrese, komisione ose në shërbime të tjera brenda dhe jashtë vendit.

83. Ministria e Punëve të Jashtme me miratim të Ministrit mund të kontraktojë persona jashtë shërbimit të jashtëm për punë që kërkojnë kompetenca të veçanta teknike (përkthime, studime historiko-diplomatike etj.) dhe që nuk mund të kryhen nga diplomatët ose nëpunësit e tjerë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kontrata me këta persona lidhet nga Sekretari i Përgjithshëm. Ajo si rregull nuk zgjat më shumë se një vit dhe mbyllet me përfundimin e punës, për të cilën personi është kontraktuar.

84. Ministri i Punëve të Jashtme merr iniciativën sipas akteve ligjore në fuqi për krijimin e grupeve të punës për hartimin e strategjive, të politikave, të studimeve ose të projektakteve të veçanta. Në këto grupe pune mund të marrin pjesë edhe persona, që nuk punojnë në administratën shtetërore. Shpërblimi i ekspertëve të grupeve të punës përballohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit ose të ndihmës së huaj për atë qëllim.

KREU XIII
REKRUTIMI I STAFIT VENDOR

85. Punësimi në përfaqësi i shtetasve të shtetit pritës bëhet, pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha burimet njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme ose të familjarëve të punonjësve të përfaqësisë.

86. Numri i shtetasve të shtetit pritës të punësuar në përfaqësi nuk duhet të kalojë 25% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të emëruar të përfaqësisë.

87. Punësimi i një punonjësi nga radhët e shtetasve të shtetit pritës bëhet mbi kriteret profesionale dhe kualifikimi profesional.

88. Miratimi për punësim bëhet nga Ministri pas përzgjedhjes ndërmjet 3 kandidaturave të dërguara nga shefi i misionit/postit.

KREU XIV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

89. Dispozitat kalimtare për dhënien e gradave diplomatike mbështeten në vjetërsinë e integruar në punë, e cila buron nga parimet dhe kriteret e përcaktuara në pikat 60, 62 dhe 63.

89.1 Me “vjetërsi të integruar në punë” kuptohet vjetërsia në punë që del nga shuma e vjetërsisë në punë jashtë shërbimit të jashtëm me vjetërsinë në punë në shërbimin e jashtëm.

89.2 Përlllogaritja e vjetërsisë në punë për efekt të vjetërsisë së integruar bëhet si më poshtë:

1. Vitet e shërbimit të nëpunësit me arsim të lartë në institucionet shtetërore të të gjitha profileve njihen për vjetërsi në shërbimin e jashtëm në raport 1:0,65;

2. Vitet e shërbimit të nëpunësit me arsim të lartë në poste drejtuese të institucioneve qendrore të vendit njihen për vjetërsi në shërbimin e jashtëm në raport 1:0,85 dhe në poste drejtuese të institucioneve të tjera shtetërore të të gjitha profileve në raport 1:0,75;

3. Vitet e shërbimit në drejtoritë e marrëdhënieve me jashtë të institucioneve qendrore të vendit njihen për vjetërsi në shërbimin e jashtëm në raport 1:1 për drejtuesin dhe 1:0,85 për specialistin.

4. Vitet e aktiviteteve publike në kuadër të shoqërisë civile, të cilat kanë lidhje me politikën e jashtme, njihen për vjetërsi në shërbimin e jashtëm në raport 1:0,50.

90. Çdo diplomat që aktualisht është në shërbimin e jashtëm, pavarësisht nga grada që mban dhe koha e marrjes së saj, ka të drejtën të përfitojë një herë nga dispozitat kalimtare, në rast se kërkesa e tij mbështetet në kriteret e përcaktuara në pikat 62, 63, 89.2 dhe 92 të kësaj rregulloreje.

91. Diplomati, që vlerëson se ka plotësuar kushtet për të marrë një gradë të re, e zgjedh vetë sesionin e Komisionit, në të cilin dëshiron të paraqesë kërkesën për marrje grade, nisur nga vjetërsia e tij e integruar në punë.

91.1 Në rast se shuma e viteve të vjetërsisë së integruar në punë qëndron ndërmjet afateve kohore ligjore të dy gradave të njëpasnjëshme, diplomati ka të drejtën ta paraqesë kërkesën e tij atëherë kur plotësohet afati kohor ligjor për marrjen e gradës më të lartë. Por ai mund të zgjedhë edhe për ta paraqitur kërkesën e tij në sesionin më të afërt të Komisionit. Në këtë rast atij i jepet grada, afatin kohor ligjor të së cilës ka plotësuar.

91.2 Kërkesat për dhënie grade të diplomatëve, që në kohën e paraqitjes së kërkesës ndodhen me shërbim në përfaqësi dhe janë emëruar me të paktën një gradë ndryshim ndaj gradës që duhet të përfitojnë sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 62, 63, 89.2 dhe 92 të kësaj Rregulloreje, nuk merren në shqyrtim. Këta diplomatë kanë të drejtën të paraqesin kërkesë për dhënie grade më të mbaruar shërbimin në përfaqësi. Ata ruajnë të drejtën për të përfituar gradë sipas përcaktimeve të bëra në pikat 90 dhe 91.1.

91.3 Shefat e përfaqësive diplomatike të emëruar në mandatin e parë të tyre sipas nenit 22 pika 2 të ligjit n.9095, duhet t'i paraqesin një kërkesë zyrtare institucionit të MPJ-së, në rast se duan të qëndrojnë në shërbimin e jashtëm diplomatik.

92. Për dhënien e gradave diplomatike në rastin e zbatimit të dispozitave kalimtare ndiqen këto afate kohore:

1. I jepet grada “sekretar i tretë” diplomatit me 3 vjet vjetërsi të integruar në punë dhe vlerësim të përgjithshëm “përgjithësisht mjaftueshëm” e lart të rezultateve në punë të vitit të fundit.

2. I jepet grada “sekretar i dytë” diplomatit me 6 vjet vjetërsi të integruar në punë dhe vlerësim të përgjithshëm “përgjithësisht mjaftueshëm” e lart të rezultateve në punë të vitit të fundit.

3. I jepet grada “sekretar i parë” diplomatit me 9 vjet vjetërsi të integruar në punë dhe vlerësim të përgjithshëm “përgjithësisht mjaftueshëm” e lart të rezultateve në punë të vitit të fundit.

4. I jepet grada “këshilltar” diplomatit me 13 vjet vjetërsi të integruar në punë dhe vlerësim të përgjithshëm të paktën në nivelin “mirë” e lart të rezultateve në punë të vitit të fundit.

5. I jepet grada “ministër këshilltar” diplomatit:

a) që ka jo më pak se 15,5 vjet vjetërsi të integruar në punë, nga të cilët 2,5 vjet vjetërsi në post drejtues “drejtor drejtorie” e lart ose “ambasador”, përfshirë këtu periudhat në poste të tjera të larta sipas përcaktimeve të pikës 63;

b) që ka jo më pak se 5 vjet punë drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm;

c) që ka marrë dy vitet e fundit vlerësim vjetor të punës jo më të ulët se “mirë” në të gjitha elementet specifike të rezultateve të punës.

6. I jepet grada “ministër fuqiplotë” diplomatit:

a) që ka jo më pak se 18 vjet vjetërsi të integruar në punë, nga të cilët 5 vjet vjetërsi në post drejtues “drejtor drejtorie” e lart ose “ambasador”, përfshirë këtu periudhat në poste të tjera të larta sipas përcaktimeve të pikës 63;

b) që ka jo më pak se 8 vjet punë drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm;

c) që ka marrë dy vitet e fundit vlerësim vjetor të punës jo më të ulët se “mirë” në të gjitha elementet specifike të rezultateve të punës.

7. Plotëson kushtet për marrjen e gradës “ambasador” diplomati që ka:

7.1. jo më pak se 20 vjet vjetërsi të integruar në punë, nga të cilët jo më pak se 10 vjet drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm;

7.2. jo më pak se 7 vjet vjetërsi në post drejtues, nga të cilat:

a) ose 5 vjet në post “drejtor drejtorie” e lart, përfshirë këtu periudhat në poste të tjera të larta sipas përcaktimeve të pikës 63, dhe një mandat të rregullt (jo më pak se 2 vjet) si “ambasador”;

b) ose 7 vjet “ambasador”.

7.3 jo më pak se 25 vjet vjetërsi të përgjithshme në punë;

7.4 vlerësime maksimale në punë për 2 vitet e fundit.

92.1 Diplomatat të cilët në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje plotësojnë kushtet për marrjen e gradës “ambasador”, konfirmohen për efekt page në gradën “ministër fuqiplotë” nga Komisioni i Gradave dhe Disiplinës deri sa të përfundojë procedura e dekretimit të dhënies së gradës “ambasador”.

ANEKSI A

Formular i vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve të shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë

Viti _____

Seksioni A

Gjeneralitetet e punonjësit

Emri

Vendi i punës

Datëlindja

Data e fillimit të punës në shërbimin civil

Data e fillimit të punës në shërbimin e jashtëm

Data e fillimit të punës në postin aktual

Seksioni B

Qëllimi i përgjithshëm i punës

Objektivat e punës
(sipas rëndësisë)

Tregoni nivelin e vlerësimit
për çdo objektiv 1-4

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____	

Seksioni C
Niveli i aftësive themelore

Tregoni nivelin e arritur për çdo aftësi 1-4.
Aftësitë e patestuara do të shënohen me x.

Drejtimi	
Gjykimi	
Puna në grup	
Shfrytëzimi i burimeve	
Vetënxitja	
Shpirti krijues	
Vetorganizimi	
Aftësia komunikuese me shkrim	
Aftësia komunikuese me gojë	
Cilësia e shërbimit	

Seksioni C 1
Niveli i aftësive themelore të diplomatit

Tregoni nivelin e arritur për çdo aftësi 1-4.
Aftësitë e patestuara do të shënohen me x.

Vëllimi i punës së përballuar brenda vitit

Llojshmëria e punës

Cilësia

Përgatitja e tezave raporteve dhe fjalimeve

Numri i takimeve dhe cilësia e tyre

Shpejtësia e reagimit dhe informimit

Ndjekja e çështjeve

Disiplina formale

Seksioni D
Vlerësimi i përgjithshëm i eprorit

(i) Zyrtari raportues

Komente të përgjithshme që tregojnë ndonjë përparësi të veçantë të punonjësit dhe ndonjë fushë ose aftësi ku duhet të bëhen përmirësime.

Kam vlerësuar punonjësin konform akteve nënligjore në fuqi dhe mendoj që niveli i përgjithshëm i mbarëvajtjes në punë është:

(1-shumë mirë; 2-mirë; 3-përgjithësisht mjaftueshëm; 4-jo mjaftueshëm)

Emri/ Firma _____
Vendi i punës _____

Shkalla _____
Data _____

(ii) Komente të bëra nga zyrtari kundërfirmues.

Emri / firma _____
Vendi i punës _____

Shkalla _____
Data _____

Seksioni E
Vërtetim marrje njoftimi

Kam lexuar dhe kam marrë një kopje të këtij vlerësimi dhe jam në dijeni se mund të bëj ankesë nëpërmjet eprorit tim të drejtpërdrejtë brenda 10 ditëve.

Emri/firma _____

Data _____

VENDIM
Nr.840, datë 17.12.2004

PËR VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik (DSHTD) është person juridik, publik, në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjen shtetërore”.

2. Objekti i veprimtarisë së DSHTD-së është:

a) Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

b) Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë e shtetit shqiptar në shtete të tjera, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

3. Të njëjtat shërbime, që DSHTD-ja kryen për trupin diplomatik, mund t’ua ofrojë edhe subjekteve, shtetërore ose private, shqiptare, si veprimtari dytësore, por që i shërbejnë objektit kryesor të veprimtarisë së saj. Në çdo rast, ushtrimi i këtyre veprimtarive në favor të këtyre subjekteve nuk duhet të pengojë apo cenojë shërbimin ndaj trupit diplomatik.

4. Për të krijuar, garantuar dhe përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë për Trupin Diplomantik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe për përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në shtete të tjera, DSHTD-ja përdor burimet e veta financiare. Gjithashtu, DSHTD-ja përballon, tërësisht apo pjesërisht, edhe shpenzimet e nevojshme për ndërtimin apo blerjen e objekteve të reja.

5. Burimet financiare të DSHTD-së janë:

a) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për trupin diplomatik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;

b) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;

c) Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera dytësore;

ç) Donacionet, vendase ose të huaja, të dhëna me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme, të cilat përdoren vetëm në funksion të veprimtarisë kryesore të DSHTD-së.

6. Kapitali themeltar i DSHTD-së është 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, i cili përballohet nga të ardhurat e veprimtarisë së kësaj drejtorie.

7. Veprimtaria ekonomiko-financiare e DSHTD-së kontrollohet nga organet përkatëse, të ngarkuara me ligj. Po ashtu edhe Ministri i Punëve të Jashtme ka të drejtë të udhërojë ushtrimin e kontroleve, të plota ose të pjesshme, për veprimtarinë e DSHTD-së, nëpërmjet strukturave të specializuara.

8. Tarifat dhe çmimet e shërbimeve, që DSHTD-ja realizon për trupin diplomatik, përcaktohen duke respektuar të drejtat e përfaqësive diplomatike, që burojnë nga konventat apo traktatet ndërkombëtare, marrëveshjet dypalëshe dhe nga parimet e reciprocitetit. Këto tarifa i bëhen të njohura edhe trupit diplomatik, të akredituar në Republikën e Shqipërisë. Tarifat dysHEME të qirasë, të diferencuara sipas destinacionit të përdorimit të objektit, si dhe çmimet e shërbimeve, që kryehen për subjekte të tjera, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Financave.

9. Ministrinë, institucionet e tjera qendrore dhe Bashkia e Tiranës, nëpërmjet strukturave dhe ndërmarrjeve të tyre vartëse, sigurojnë me përparësi shërbime cilësore për mjediset që administrojnë DSHTD-ja, veçanërisht për furnizimin me energji elektrike, ujë, ndërlidhje telefonike, pastrim etj., në funksionin të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

10. Mënyra e organizimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së DSHTD-së, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre, përcaktohen në statutin, që miratohet nga Ministri i Punëve të Jashtme.

11. Vendimi nr.113, datë 26.2.1993 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe institucionet e përmendura në pikën 9 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Nr.841, datë 17.12.2004

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION, TË FORMËS “BOT”, TË AUTOSTRADËS RROGOZHINË-TIRANË (PEZË)-RINAS-THUMANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 2 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime dhe në infrastrukturë”, të ndryshura, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT”, të autostradës Rrogozhinë-Tiranë (Pezë)-Rinas-Thumanë, sipas projektit të paraqitur nga shoqëria “STRABAG, A=WAY INFRASTRUKTUR PROJEKTENTWIK LUNG-UND-BERT IEBS, GMBH”, si propozim i pakërkuar.

2. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit të jetë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për të negociuar dhe nënshkruar marrëveshjen e koncesionit.
3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.845, datë 17.12.2004

PËR SHFUQËZIMIN E VENDIMIT NR.506, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NDËRTIMIN ME KONCESION TË AUTOSTRADËS RROGOZINË-PEZË-DEGËZIM TIRANË-VORË-THUMANË DHE ÇAKTIMIN E ORGANIT SHTETËROR TË AUTORIZUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 deri 129 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Vendimi nr.506, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.846, datë 17.12.2004

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION, FORMËS “BOT, TË RRUGËS RRËSHEN-KALIMASH, PJESË E KORRIDORIT DURRËS-KUKËS-MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 2 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT” të rrugës Rrëshen-Kalimash, pjesë e korridorit Durrës-Kukës-Morinë, sipas projektit të paraqitur nga shoqëria “STRABAG, A=WAY INFARSTRUKTUR PROJEKTENTWIK LUNG-UND-BERT IEBS GMBH”, si propozim i pakërkuar.

2. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit të jetë organi shtetëror i autorizuar (OSHA), për të negociuar dhe nënshkruar marrëveshjen e koncesionit.

3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.882, datë 22.12.2004

PËR SHPËRBLIMIN E ISH-PUNONJËSVE TË UZINËS SË FERROKROMIT NË BURREL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësve të Uzinës së Ferrokromit në Burrel, të cilëve u janë shkurtuar vendet e punës, si rezultat i zbatimit të marrëveshjes së koncesionit, të miratuar me ligjin nr.8791, datë 10.5.2001, t’u jepet një shpërblim i barabartë me 2 paga bazë mujore të vendit të punës.

2. Fondi prej 9 100 000 (nëntë milionë e njëqind mijë) lekësh, për shpërblimin e këtyre punonjësve, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.294, datë 22.12.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“ASPARAG”
SUBJEKTIT: Z. BARDHYL TOSKU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, si dhe të vendimit nr.287, datë 29.10.2004 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për marrjen e licencës së subjektit televiziv kabllor TV Asparag” të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit, ky i fundit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Bardhyl Tosku, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Rrogozhinës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.295, datë 22.12.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TV BULQIZA”
SUBJEKTI: SHOQËRIA “MARIUXHO” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004 Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Mariuxho” sh.p.k, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Bulqizës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.296, datë 22.12.2004

PËR DHËNIEN E LICENCE

PËR RADIO VENDORE PRIVATE
“LEZHA”
SUBJEKTIT: Z. GJOVALIN DUSHAJ

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radio dhe televisionin shqiptar publik e privat në republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatoreve private radio e televizive”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin shtator, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Gjovalin Dushaj, me vendndodhje në qytetin e Lezhës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulimin në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
 2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.297, datë 22.12.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TV KUKËSI”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “TELEVIZIONI KUKËS” SHA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit.

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Televizioni Kukës” sh.a., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Kukësit, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.298, datë 22.12.2004

PËR HEQJEN E LICENCËS SË “TV SHIJAK”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Halil	Lalaj	Kryetar
Albert	Minga	Zëvendëskryetar
Sefedin	Çela	Anëtar
Lazër	Stani	Anëtar
Visar	Zhiti	Anëtar
Agim	Duro	Anëtar
Fatos	Lulo	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKTI: Mbi heqjen e licencës së “TV Shijak”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 33 pika 5, neni 40/1, vendimet e KKRT-së nr. 215, datë 26.2.2004 “Mbi shlyerjen me këste të pagesave për licencë për vitin 2003 të disa subjekteve televizive”, nr.265, datë 3.9.2004 “Mbi transmetimet pirate të subjektit TV Shijak”, nr.266, datë 30.9.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private” dhe nr.291, datë 12.11.2004 “Mbi vendosjen e disa detyrimeve ligjore ndaj televizionit vendor privat TV Shijak”.

Shoqëria “Media +” sh.a. është licencuar me vendimin nr.30, datë 14.11.2000 të KKRT-së si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për televizionin “TV Shijak”, me nr.licence 039/TVL. Afati i licencës është 5 vjet nga dita e botimit të vendimit për dhënien e licencës në Fletoren Zyrtare (3.1.2001).

Me vendimin nr.266 pika 1/3, datë 30.9.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private” Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka vendosur të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor “TV Shijak”, pasi nuk ka shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2003. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjektit i është lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim.

Pasi dëgjoi pretendimet e subjektit, përfaqësuar nga z.Gëzim Ismaili, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit me vendimin nr.291, datë 12.11.2004 “Mbi vendosjen e disa detyrimeve ligjore ndaj televizionit vendor privat TV Shijak”, ka vendosur datën 30 nëntor 2004 si afat për:

- depozitimin nga ana e subjektit “TV Shijak” të dokumentacionit që vërteton se zotëron të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitje, shkëmbimi ose dhurimi si dhe për,

- shlyejën e pagesës vjetore të licencës për vitin 2003.

- Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjekti televiziv vendor privat “TV Shijak” detyrohej për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të paligjshme.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE I TELEVISIONIT,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes, znj. Argita Shkupi, z. Andrea Nathanaili dhe znj. Ermira Mushi, subjekti në mungesë,

VËREN:

I. Me vendimin nr.215 pika 1/8, datë 26.2.2004 “Mbi shlyerjen me këste të pagesave për licencë për vitin 2003 të disa subjekteve televizive”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka miratuar shlyerjen me pesë këste të pagesës vjetore të licencës për vitin 2003, në shumën 528.8 mijë lekë të operatorit televiziv vendor privat “TV Shijak”. Afati për shlyerjen e kësaj pagese, bazuar në memorandumin dypalësh të miratuar sipas pikës 2 të vendimit të mësipërm, ka qenë deri në datën 30 qershor 2004.

Ky memorandum i është dërguar subjektit “TV Shijak” me shkresën nr.254, datë 27.2.2004, por nuk është nënshkruar nga ana e tij. Subjekti, me gjithë kalimin e afateve për secilin këst, të përcaktuara në memorandum, nuk ka shlyer asnjë pjesë të pagesës vjetore të licencës për vitin 2003. Në rastin e mospagimit të kësteve brenda afatit, në memorandum është parashikuar e drejta e KKRT-së për heqjen e licencës.

Bazuar në këtë vendim, KKRT me vendimin nr.266 pika 1/3, datë 30.9.2004, ka vendosur paraprakisht të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor “TV Shijak”.

KKRT-ja vëren se, bazuar në nenin 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të bëjë të pavlefshme licencën kur subjekti nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj.

II. Gjithashtu, grupi i inspektimit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit, ka ndjekur në vazhdimësi funksionimin ligjor të subjektit “TV Shijak”, lidhur me shkeljen e të drejtave të transmetimit për programet e transmetuara.

Për programet e transmetuara i është kërkuar subjektit “TV Shijak” dokumentacioni që vërteton të drejtën e transmetimit, duke caktuar dhe afate për depozitimin e tyre. Ekziston një praktikë e gjerë shkresore, e cila ka filluar që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9124, datë 29.7.2003 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë””.

Transmetimet e paligjshme janë të regjistruara dhe të ruajtura në KKRT.

Për shkelje konkrete, subjekti “TV Shijak” është ndëshkuar nga grupi i inspektimit të KKRT-së me gjobat si vijojnë, duke arritur shumën totale 19 000 000 lekë:

- a) Gjoba nr. 0048, datë 21.10.2003 në masën 200 000 lekë;
- b) Gjoba nr. 0052, datë 22.10.2003 në masën 400 000 lekë;
- c) Gjoba nr. 0053, datë 24.10.2003 në masën 500 000 lekë;
- d) Gjoba nr. 0054, datë 27.10.2003 në masën 600 000 lekë;

e) Gjoba nr. 0056, datë 15.12.2003 në masën 200 000 lekë.

Për katër gjobat e para, subjekti ka bërë në datën 30.10.2003 ankim në KKRT, duke kërkuar anulimin e gjobave të vendosura nga grupi i inspektimit të KKRT-së. Pas shqyrtimit të kësaj ankesë, KKRT-ja ka vendosur me vendimin nr.193, datë 14.11.2003 miratimin e gjobave të vendosura nga grupi i inspektimit. Për ekzekutimin e këtij vendimi, është ngarkuar me urdhër të posaçëm (nr. 92, datë 26.11.2003), në mbështetje të nenit 137/5 “Bashkëpunimi me organet e tjera”, Policia Tatimore.

KKRT-ja vëren se, pas vendosjes së gjobës së pestë, nga ana e subjektit “TV Shijak” është ndërprerë transmetimi i programeve të kundërligjshme. Këto transmetime kanë rifilluar në muajin korrik 2004 me disa veprimtari sportive pirate, e më vonë me transmetimin e përditshëm të filmave artistikë, për të cilët nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.

KKRT-ja vëren se, në bazë të nenit 40/1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, operatorët radiotelevizivë të licencuar detyrohen të depozitojnë pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dokumentacionin që vërteton se zotërojnë të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitje, shkëmbimi ose dhurimi.

Gjithashtu, në bazë të nenit 137/4 pika 7 parashikohet dënim me gjobë nga 200 000 deri në 1 000 000 lekë, kur subjektet RTV transmetojnë programe që nuk i kanë prodhuar vetë dhe për të cilat nuk kanë marrëveshje, kontratë shitje shkëmbimi ose dhurimi nga subjektet e tjera radiotelevizive, prodhuesit apo shpërndarësit e autorizuar të tyre. Përsëritja e kësaj shkeljeje më shumë se 5 herë dënohet me uljen deri në 50 për qind të afatit të licencës. Në rast ripërsëritjeje shkelja ndëshkohet me heqjen e licencës.

Me vendimin nr.265, datë 3.9.2004 “Mbi transmetimet pirate të subjektit TV Shijak”, pasi dëgjoi pretendimet e subjektit, përfaqësuar nga Z.Gëzim Ismaili, i cili deklaroi se të gjitha programet e transmetuara janë me të drejta të ligjshme, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit vendosi datën 24 shtator 2004 si afat të fundit për depozitimin nga ana e subjektit “TV Shijak” të dokumentacionit që vërteton se zotëron të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitje, shkëmbimi ose dhurimi.

Nga ana e subjektit “TV Shijak”, në datën 6.10.2004 janë depozituar vetëm tri fatura të lëshuara nga Rai Trade, me nr.40531, 40532 dhe 40533 të datës 31.3.2004 për blerjen e telenovelës “Cuori rubati”.

Mbi bazën e vendimit nr.265, pasi dëgjoi dhe pretendimet e subjektit, me vendimin nr. 291, datë 12.11.2004 “Mbi vendosjen e disa detyrimeve ligjore ndaj televizionit vendor privat TV Shijak”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit vendosi datën 30 nëntor 2004, si afat për:

- depozitimin nga ana e subjektit “TV Shijak” të dokumentacionit që vërteton se zotëron të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitje, shkëmbimi ose dhurimi, si dhe për,

- shlyerjen e pagesës vjetore të licencës për vitin 2003.

Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjekti televiziv vendor privat “TV Shijak” detyrohej të ndërpriste menjëherë transmetimet e paligjshme.

Në lidhje me këtë vendim, Departamenti i Programeve vazhdoi monitorimin e transmetimeve të operatorit “TV Shijak” për periudhën nga data 12 nëntor 2004, që është edhe data e hyrjes në fuqi, e deri në datën 30 nëntor 2004 si afati i fundit i përcaktuar në vendim për plotësimin e detyrimeve të përcaktuara nga KKRT.

Nga ky monitorim rezultoi që:

- Subjekti televiziv “Shijak”, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton se zotëron të drejtën e transmetimit të programeve.

- Televizioni “Shijak”, nuk ndërpreu transmetimet e paligjshme, siç kërkohet në pikën 2 të vendimit nr.219 të KKRT-së. Nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi e deri në datën 30 nëntor janë transmetuar nga “TV Shijak” në mënyrë pirate filma artistikë, dokumentarë apo koncerte për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacionin e duhur.

Gjithashtu, televizioni “Shijak”, ka vazhduar edhe gjatë muajit dhjetor 2004 të transmetojë programe pirate, duke shkelur kërkesat e vendimit nr.291, datë 12.11.2004 të KKRT-së, si dhe kërkesat e ligjit nr.9124, datë 29.7.2003. Këto transmetime janë monitoruar me sondazhe dhe janë

të regjistruara dhe të arkivuara.

Televizioni “Shijak” nuk ka zbatuar as pikën 4 të vendimit të sipërpërmendur, lidhur me publikimin e këtij vendimi në edicionet informative.

Aktualisht, “TV Shijak” vazhdon ende të transmetojë programe pirate, duke cenuar konkurrencën e ndershme në fushën e mediave elektronike, ndërkohë që operatorë të tjerë radiotelevizivë kanë shpenzuar shuma të konsiderueshme për blerjen e tyre.

Në mbështetje të nenit 137/3 “Për t’i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi”, është njoftuar subjekti me shkresën nr.1270/2, datë 16.12.2004.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në bazë të neneve 7 pika 21, 33, pika 5 dhe 40/1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të vendimeve të KKRT-së nr.215, datë 26.2.2004, nr.265, datë 3.9.2004, nr.266, datë 30.9.2004 dhe nr.291, datë 12.11.2004

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën shoqërisë “Media +” sh.a. për televizionin vendor privat “TV Shijak”;
2. Licenca nr.039/TVL bëhet e pavlefshme;
3. Subjekti “TV Shijak” është i detyruar të ndërpresë menjëherë transmetimin;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”;
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM

Nr.299, datë 22.12.2004

PËR HEQJEN E LICENCËS SË “TV DRINI”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Halil	Lalaj	Kryetar
Albert	Minga	Zëvendëskryetar
Sefedin	Çela	Anëtar
Lazër	Stani	Anëtar
Visar	Zhiti	Anëtar
Agim	Duro	Anëtar
Fatos	Lulo	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKTI: Mbi vlefshmërinë e licencës së “TV Drini”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 33 pika 5, vendimi i KKRT-së nr.215, datë 26.2.2004 i KKRT-së “Mbi shlyerjen me këste të pagesave për licencë për vitin 2003 të disa subjekteve televizive”, vendimi i KKRT-së nr.266, datë 30.9.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private”.

Subjekti fizik Sajmir Nasufi është licencuar me vendimin nr.29, datë 30.10.2000 si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për televizionin “TV Drini”, me nr. licence 033/TVL.

Me vendimin nr.266 pika 1/2, datë 30.9.2004 "Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private", Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka vendosur të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor "TV Drini", pasi nuk ka shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2003. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjektit i është lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim.

Nga ana e subjektit "TV Drini" nuk është paraqitur asnjë pretendim.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE I TELEVISIONIT,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes, znj.Argita Shkupi dhe znj.Ermira Mushi, subjekti në mungesë,

VËREN:

Me vendimin nr.215 pika 1/5, datë 26.2.2004 "Mbi shlyerjen me këste të pagesave për licencë për vitin 2003 të disa subjekteve televizive", Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka miratuar shlyerjen me pesë këste të pagesës vjetore të licencës për vitin 2003, në shumën 25.8 mijë lekë, të operatorit televiziv vendor privat "TV Drini". Afati për shlyerjen e kësaj pagese, bazuar në memorandumin dypalësh të miratuar sipas pikës 2 të vendimit të mësipërm, ka qenë deri në datën 30 qershor 2004.

Ky memorandum i është dërguar subjektit "TV Drini" me shkresën nr.254, datë 27.2.2004, por nuk është nënshkruar nga ana e tij. Subjekti, me gjithë kalimin e afateve për secilin këst, të përcaktuara në memorandum, nuk ka shlyer asnjë pjesë të pagesës vjetore të licencës për vitin 2003. Në rastin e mospagimit të kësteve brenda afatit, në memorandum është parashikuar e drejta e KKRT-së për heqjen e licencës.

KKRT-ja vëren se, bazuar në nenin 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ka të drejtë ta bëjë të pavlefshme licencën kur subjekti nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj.

KKRT-ja me vendimin nr.266 pika 1/2, datë 30.9.2004, ka vendosur paraprakisht, ta bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor "TV Drini".

Në mbështetje të nenit 137/3 "Për t'i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi", është njoftuar subjekti me shkresën nr.1023, datë 4.10.2004 dhe më pas, për shkak të shtyrjes së shqyrtimit të çështjes është bërë njoftim për të marrë pjesë me shkresën nr.1270/1, datë 16.12.2004.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në bazë të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe të vendimeve nr.215, datë 26.2.2004 dhe nr.266, datë 30.9.2004 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën subjektit televiziv vendor privat "TV Drini";
2. Licenca nr. 033/TVL bëhet e pavlefshme;
3. Subjekti "TV Drini" është i detyruar të ndërprese menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative";
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 28.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë